



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4278 Prot.

Roskovec, më 31.08 2020

VENDIM

NR 65 .DATË 28.08 .2020

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN KORRIK 2020”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 28.07.2020, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Korrik 2020.
- 2- Ngarkohet Sekretaria e Këshillit Bashkiak me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 3804/1 Prot.

Roskovec, më 30.07.2020

Procesverbal Nr.7

-I mbajtur sot, date 28.07.2020, ora 11, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes. Mbledhja po zhvillohet ne sallen e madhe te Pallatit te Kultures e cila siguron ruajtjen e distances fizike te uljes se antareve te keshillit dhe qytetareve, duke zbatuar vendimet e qeverise. Keshilltaret jane paraqitur me maska. Rendi i dites :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Qershor 2020.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Qershor 2020.
5. Për anulim të Vendimit Nr.44 datë 29.06.2020 “Për një ndryshim në Vendimin Nr.37 datë 29.05.2020 “Për miratimin e Rregullores për Funksonimin e Tregut Publik në Bashkinë Roskovec”
6. Për një ndryshim në Vendimin Nr.37 datë 29.05.2020 “Për miratimin e Rregullores për Funksonimin e Tregut Publik në Bashkinë Roskovec”.
7. Për miratimin e planit vjetor të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Roskovec për vitin 2021.
8. Për një shtesë në Vendimin Nr.105 datë 22.11.2019 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2020”.
9. Për një ulje të tarifës së pastrimit për subjektet private të cilët u prekën nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-19”.
10. Për miratimin e vendqëndrimeve në linjat rrethqytetëse.
11. Për dhënien me qira të truallit për tu përdorur për qëllime kulturore, arsimore dhe sportive.
12. Për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandarë në pronësi të Bashkisë Roskovec.
13. Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2021-2023.
14. Për miratim dhe transferim fondesh në Buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2020.
15. Kthim përgjigje mbi numrin e grave kryefamiljare që drejtojnë një biznes. Kërkesë e Komisionit për Barazinë Gjinore dhe Çështjeve Sociale.
16. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 11⁰⁵

Keshilltaret prezant: A.Kola, K.Kuka, E.Çepele, Rr.Hazizi, L.Hoxha, L.Goga, B.Çobo, B.Kuka, D.Hoxha, K.Hyska, G.Hoxha, A.Hazizi, V.Dogani, A.Sheme, V.Stani, H.Beqiraj, M.Sufka.

Keshilltaret qe mungojne : Viktor Mata, Tajane Kuka, Vjollca Bakaj, Bajame Toska.

Te pranishem nga administrata e bashkise: Nenkryetari M.Goga, Dr.Juridike, P/Z/Tatim-Taksave, Sp.Ndihmes Ekonomike, Sp.Urbanistikes, Dr.Finances, Sp.Bujqesise, Sp.Transportit dhe disa qytetare.

Me plotesimin e kuorumit, kryetari i keshillit hap mbledhjen. Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 17 keshilltare.

Kryetari hap mbledhjen. Fillon me rendin e dites.

1. Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Kryetari i Keshillit hedh ne votim rendin e dites dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Qershor 2020.

Sekretarja e keshillit sqaron vendimet. Leksi-per cfare arsye i kthen Prefekti keto vendime? Sekretarja sqaron se do ta kalojme ne nje pike me pas te rendit te dites. Sqaron vendimet e zbardhura dhe ndarjen e akteve normative, konfirmimin e Prefektures.

3. Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Sekretarja e keshillit sqaron procesverbalin e zbardhur. Hidhet ne votim dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro procesverbalit.

4. Per dhenien e Ndihmes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-30 Qershor 2020.

Nuk ka pyetje. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

5. Per anulim te Vendimit Nr.44 date 29.06.2020 "Per nje ndryshim ne Vendimin Nr.37 date 29.05.2020 "Per miratimin e Rregullores per Funkcionimin e Tregut Publik ne Bashkine Roskovec".

Elmazi-pse na i sillni kur nuk jane ne perputhje me ligjin? Leksi-nuk eshte shkelje e ligjit, na eshte bere Prefekti si president, une nuk shoh asnje shqetesim per kete projekt, nuk eshte shkelur ligji. Ne i kalojme vendimet por nuk e dime zbatimin e tyre. Nenkryetari M.Goga sqaron se cdo projekt ka nje baze ligjore, nese Prefekti e kthen heren e pare, ne e sjellim perseri per miratim dhe kemi te drejte ta zbatojme. Prefektura ka gjetur vetem nje klauzole jo sekuestrim por administrim te mallit. Hidhet ne votim projekti i anulimit te vendimit Nr.44 date 29.06.2020 dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

6. Per nje ndryshim ne Vendimin Nr.37 date 29.05.2020 "Per miratimin e Rregullores per Funkcionimin e Tregut Publik ne Bashkine Roskovec"

Nuk ka pyetje. Aleksandri-ne kemi zyren tone juridike, ne rast se ligji nuk eshte i njejte per te gjitha dhe nga momenti qe po bejme ndryshimin i bie qe paska te drejte prefektura. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

7. Per miratimin e planit vjetor te aktiviteteve te Keshillit Bashkiak Roskovec per vitin 2021.

Mentorja e keshillit Engjellushe Zenelaj sqaron se ne mbledhjen me kryetaret e komisioneve dhe kryetarin, sekretaren, nenkryetarin kemi percaktuar planin e aktiviteteve qe do te behen per vitin 2021. Sqaron specifikisht pjesen e konsultimeve me publikun, edhe keshilli duhet te bej vet degjesat e tij publike. Ky eshte plani por sdo te thote se sdo te kete edhe ndryshime gjate rruges, ose qe ky plan do te jete 100% i zbatueshem si ky, mund te kete edhe me vone. Elmazi-ky plani do te kalohet

atehere kur te kaloj dhe buxheti.Engjellushja-duhet te jemi realist per kerkesat tona.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro plani i aktiviteteve te keshillit bashkiak per vitin 2021.

8.Per nje shtese ne Vendimin Nr.105 date 22.11.2019 “Per miratimin e Paketës Fiskale per vitin 2020”

Sp.Urbanistikes sqaron shtesen e tarifës per vendosjen e tendave te diellit.Kudreti-po ai qe e ka bere tenden 2 milion do tja hedhim poshte?Nenkryetari M.Goga sqaron se kemi miratuar nje rregullore urbane ku kemi unifikuar vendosjen e tendave.Irena-shume shpejt do vihet ne zbatim PPV,dhe te gjitha tendat duhet te jene te unifikuara,kjo eshte ligj.Elmazi-me tarifën 20 mije leke nuk jam dakort,ler te jete 10 mije leke.Leksi-mos ndryshon perseri ajo rregullore qe ne kemi miratuar?jam dakort me Elmazin,ta ulim pak tarifën ne 15 mije leke 25% ulje,sa na e jep ligji.Aleksander-nuk jam kunder unifikimit,me pare jane bere pa tarife.Neser mund te dali nje tjetër unifikim dhe kjo eshte kosto.Une jam kunder kesaj tarife,te jete zero ose ta bej vet bashkia.Bujari-tek blloku nr.2 ju po bini cdo muaj shtesa,na kerkojne neve llogari qytetaret si keshilltare.Ne kete kohe te veshtire ne po i rendojme pak qytetaret.Nenkryetari-kjo tarife eshte vetem per ata qe do vendosi tenda,te tjeret nuk jane te detyruar te vendosin nese nuk duan.Kudreti-ai qe ka tende aktuale i bie qe ai eshte i detyruar ta heqi qe ta unifikojë.Nenkryetari M..Goga-ne degjese publike qytetaret rane dakort nuk shprehen kundërshtime.Keshilltaret debatojne me njeri-tjetër.Elmazi-ne rast se ju i merni vet keto vendime mos i sillni ne keshill,sepse qytetaret jashte na kapin ne.Mendimi im eshte nese keshilli eshte dakort ta kaloj ler ta kaloj,nese nuk eshte dakort mos ta kalojme,ka kohe per tu bere keto gjera,mos ti rendojme tani.Bujari-disa mbledhje me pare ne kemi kaluar nje tarife tregu,kolegu yne beri propozimin nga 50 ne 35 leke dhe ne mbledhjen tjetër ju na e sollet perseri propozimin tone qe bem nje mbledhje me pare.Nenkryetari M.Goga ne e kemi zbatuar 35 leke tarifën pas vendimit te keshillit.Leksi-per problemin e tarifës se tregut nuk e kam problem nese miratohet mendimi im,por kur une e thashe te gjithë koleget e mi me dolen kunder.Mua me shqeteson fakti qe pasi ata e moren kete lloj tarife ata po hedhin balte mbi keshillin.Grupet e punës duhet tua sqarojne qe ky propozim erdhi nga zyra dhe tu sqarojne m2.Hidhet ne votim projekti sipas propozimit nga zyra perkatese dhe miratohet me 13 vota pro,3 vota abstenim dhe 1 kunder.Kryetari i keshillit kerkon 5 minuta pushim.Miratohet 5 minuta pushim.Elmazi-ne e votuam ate vendim dhe ai do zbatohet.Bujari-nese ne votojme pa vetdije mund te terhiqemi.Kryetari-ta kishe mendjen,ne e hodhem dhe e votuam me 3 abstenim dhe 1 kunder,te tjerat pro.

9.Per nje ulje te tarifës se pastrimit per subjektet private te cilet u preken nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-19”.

P/Z/Ditmira sqaron projektin.Duke u nisur nga situata e Covid-19 ne kemi menduar nje ulje te tarifës se pastrimit per aq dite sa keto subjekte nuk e kane mar kete sherbim.Llogaritja do te behet sipas diteve qe kane qene mbyllur.Genci-jane llogaritur sa dite kane qene mbyllur?Bujari-ka biznese qe e kane bere pagesen dhe si do veprohet ne kete rast?Ditmira sqaron se do te kompensohen vitin qe vjen.Leksi-ulja e kesaj tarife mos krijon faliment per ndermarrjen e pastrimit?Nenkryetari-nuk ka lidhje me kete.Bujari-ne jemi nje nga 10 bashkite me te forta dhe te marim vendime tu ulim tarifa qytetareve.Mateus-ne lidhje me bizneset qe kane qene te hapura?Ditmira sqaron Mateusin se do ta shohim sipas rastit.Valbona-po kompensimi pse duhet te jete vitin tjetër?Hidhet ne votim projekti dhe miratohet me 16 vota pro dhe 1 vote kunder

M.Sufka,duke perfshire edhe kompensimin e atyre subjekteve qe e kane paguar kete tarife,ne vitin 2021 kompensimi.

10.Per miratimin e vendqendrimeve ne linjat rrethqytetese.

Mirel Prifti sp.transportit sqaron projektin.Duhet ti miratojme vendqendrimet e linjave rrethqytetese per ti ardhur ne ndihme qytetareve.Jane percaktuar vendqendrimet.Alketi-bileta nga 700 leke eshte bere 1000 leke.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro vendqendrimet e linjave rrethqytetese.

11.Per dhenien me qira te truallit per tu perdorur per qellime kulturore,arsimore dhe sportive.

P/Dr.Juridike Drinalda Fejzulla sqaron projektin sipas materialit.Leksi-me sqaro pak fjalen enfiteoze?Nenkryetari-shkolla kerkon ti mari me qira per aktivitete sportive,kulturore,eshte prone e bashkise.Genci-mos eshte ne proces gjyqesor kjo prone?Nenkryetari-eshte prone e bashkise me karteles prone.Irena-eshte shpronesuar me vkm.Hidhet ne votim projekti per dhenien me qira te truallit per tu perdorur per qellime kulturore,arsimore,sportive sipas projektit te paraqitur dhe miratohet me 15 vota pro(3/5+2),1 vote kunder G.Hoxha dhe 1 vote abstenim L.Goga.

12.Per dhenien me qira te tokes bujqesore te pandare ne pronesi te Bashkise Roskovec.

P/Dr.Juridike Drinalda sqaron projektin per dhenien me qira te tokes bujqesore ne pronesi te Bashkise Roskovec.Leksi-ne tetor vjet kam bere pyetje nga keto tokat e ndara a jane ne rregull me detyrimet qe i kane bashkise?ju ne nje ze thate po jane.Na jepni informacion ne lidhje me kontratat.M.Goga-kontratat do te zgjidhen pas mbarimit te afatit ligjor.Elmazi-ju na keni thene qe ne keto ua kemi percjelle gjykates,per kontratat e 2012.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro (3/5+4) dhenia me qira e tokes bujqesore e pandare ne pronesi te Bashkise Roskovec.

13.Per miratimin e tavanave perfundimtare te shpenzimeve per programin buxhetor afatmesem 2021-2023.

Dr.Finances Selman Çepele sqaron tavanet perfundimtare te shpenzimeve per programin buxhetor afatmesem 2021-2023.Brenda 15 shtatorit do miratojme tavanet perfundimtare.Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

14.Per miratim dhe transferim fondesh ne Buxhetin e Bashkise Roskovec per vitin 2020.

Dr.Finances sqaron fondin per mbushje te parcelave bujqesore me lende inerte,zhavorr mali.M.Goga- keni miratuar fondin per blerjen e skrepit,ne cdo fshat do nderhyet ne rruge,kerkohet karburant per kryerjen e tyre.Leksi-e pershendetem blerjen e skrepit,ndermarrja e pastrimit ka nevojte per nje makine.Alketi-tek pjesa e parcelave,per kanalet vaditese te tokave,a mund te paguaj cdo person sa m linear ka?Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro sipas materjalit te paraqitur.

15.Kthim pergjigje mbi numrin e grave kryefamiljare qe drejtojne nje biznes.Kerkese e Komisionit per Barazine Gjinore dhe Çeshtjeve Sociale.

Kryetare e komisionit Borana sqaron kerkesen e bere per grate kryefamiljare qe drejtojne nje biznes,dhe nga pergjigja e ardhur rezultojne se jane 3 gra kryefamiljare qe drejtojne nje biznes.Ne mbledhjen tjeter do ju propozojme ndermarrjen e nje nisme per keto gra,por pasi te konsultohemi edhe me antaret e komisionit dhe strukturat perkatese.

16.Diskutime dhe komente te qytetareve.

Elmazi-problemi i punonjesve te pastrimit te plehrave,kemi dhene mendim per shperblim.Ne Suk 1 dhe Arapaj nuk ka pike uji as per te pire as per tu lare.Ne bllokun e SMT-se jane 4 rruge nga 100 m pa shtruar dhe ka shume barishte,te pastrohet bari.Rruga e Shehallareve eshte e prishur,problem

nder vite-Hekurani.Genci-tek unaza e re e Roskovecit te vihen 2 barriera nga rruga e varrezave deri tek rotondo sepse kalojne makinat me shume shpejtesi dhe perben rrezik per banoret e zones.Nuk ka me pyetje.Kryetari i keshillit mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Kadri Hyska

